

Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore

Viti 2020


Tiranë, më 6 maj 2022: Në vitin 2020¹, lënda e parë e nxjerrë nga burimet e brendshme natyrore, e cila përfaqëson sasinë totale të materialeve që përdoren direkt në ekonomi, është rreth 18,5 milionë ton, duke shënuar një rënie prej 15,6 %, krahasuar me vitin 2019. Struktura e burimeve të brendshme natyrore, tregon që produktet “minerale jo metalike” zënë rreth 46 %, “biomasa” 40 %, “mineralet metalike” 8 % dhe “materialet e energjisë fosile” 6 % të materialeve gjithsej.

Tab. 1 Burimet e brendshme natyrore

(mijë ton)

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Biomasa	8.066,5	8.164,1	7.970,6	7.747,5	7.422,6
Mineralet dhe koncentratet metalike	1.180,0	1.356,8	1.766,0	2.150,7	1.492,1
Mineralet jo metalike	18.062,5	10.593,3	11.074,6	10.742,5	8.484,6
Materialet fosile të energjisë	1.161,2	1.304,9	1.582,6	1.291,2	1.113,9
Gjithsej	28.470,1	21.419,1	22.393,8	21.931,9	18.513,2

Fig.1 Struktura e burimeve të brendshme natyrore



¹ Të dhënat e publikuara në këtë njoftim për media i referohen vitit të parë të pandemisë COVID-19 dhe si të tilla duhet të lexohen në këtë kontekst.

Sasia totale e importit të materialeve mjedisore në vitin 2020 ishte rreth 4,9 milionë ton, e cila krahasuar me vitin 2019 është 3,2 % më e lartë. Pjesën më të madhe e zënë produktet e “biomasës” me rreth 1,4 milionë ton të shoqëruar nga produktet “mineralet dhe koncentratet metalike” me 1,1 milionë ton. Më pas renditen produktet “mineralet jo metalike” gjithashtu me rreth me 1,1 milionë ton, “materialele fosile të energjisë” me 1,0 milionë ton dhe në fund “produkte të tjera dhe mbetjet e importuara” me 0,3 milionë ton.

Tab. 2 Importet e materialeve mjedisore

(mijë ton)

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Biomasa	1.369,5	1.378,4	1.465,3	1.474,4	1.440,6
Mineralet dhe koncentratet metalike	752,4	829,9	883,6	956,4	1.077,3
Mineralet jo metalike	770,4	954,9	905,9	1.011,0	1.053,1
Materialet fosile të energjisë	891,1	813,0	912,6	976,4	1.001,8
Produkte të tjera dhe mbetje të importuara	282,2	302,2	319,1	315,7	312,6
Gjithsej	4.065,6	4.278,4	4.486,5	4.733,8	4.885,5

Eksportet në vitin 2020 arritën një vlerë prej rreth 4,1 milionë ton, duke pësuar një rënie prej 2,9 %, krahasuar me vitin 2019. Ndikim më të madh në rënieën e eksporteve të materialeve mjedisore e kanë dhënë “materialele fosile të energjisë, eksportet e të cilave shënuan një rënie prej 12 %. Gjatë vitit 2020 ka pësuar rënie edhe eksportet e kategorive “mineralet dhe koncentratet metalike” me 4,8 % dhe mineralet jo metalike me 1,4 %. Nga ana tjetër eksportet e kategorive “produktet të tjera dhe mbetjet e eksportuara” dhe “biomasa” kanë patur rritje përkatësisht me 22 % dhe 3,6 %.

Tab. 3 Eksportet e materialeve mjedisore

(mijë ton)

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Biomasa	331,2	369,1	373,5	419,3	434,2
Mineralet dhe koncentratet metalike	1.242,1	1.262,6	1.140,2	1.282,2	1.220,9
Mineralet jo metalike	1.266,4	1.459,0	1.475,0	1.493,0	1.472,4
Materialet fosile të energjisë	997,2	712,6	758,3	843,1	742,2
Produkte të tjera dhe mbetje të eksportuara	122,2	144,7	196,5	200,9	245,0
Gjithsej	3.959,0	3.947,9	3.943,5	4.238,4	4.114,7

Bilanci fizik tregtar i cili tregon diferencën midis importeve dhe eksporteve për të gjithë kategoritë e materialeve mjedisore arriti vlerën e rreth 771 mijë ton për vitin 2020, duke pësuar rritje me rreth 275,4 mijë ton, krahasuar me vitin 2019. Siç mund të vërehet në Figurën 2, për vitin 2020 produktet e “biomasës”, “materialele fosile të energjisë” dhe “produktet e tjera dhe mbetjet” kanë bilanc tregtar pozitiv ndërsa produktet “mineralet jo metalike” dhe “mineralet dhe koncentratet metalike” kanë bilanc tregtar negativ.

Tab.4 Bilanci fizik tregtar

(mijë ton)

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Bilanci Fizik Tregtar	106,6	330,5	543,0	495,4	770,8
Import	4.065,6	4.278,4	4.486,5	4.733,8	4.885,5
Export	3.959,0	3.947,9	3.943,5	4.238,4	4.114,7

Fig.2 Bilanci fizik tregtar

(mijë ton)




Tabela 5 tregon varësinë nga importi i metarialeve mjedisore, e cila llogaritet si raporti ndërmjet importeve të materialeve mjedisore dhe inputeve direkte të materialeve (IDM) në ekonominë Shqiptare. IDM vlerësohet si shuma e materialeve të nxjerra nga burimet e brendshme natyrore dhe importeve të materialeve. Gjatë vitit 2020 varësia nga importi i materialeve u vlerësua në 20,9 %, duke shënuar një rritje prej 3,1 pikë përqindje, në krahasim me një vit më parë. Gjatë periudhës 2016 – 2020 varësia nga importi i materialeve është luhatur në kufijtë prej 12,5 % në vitin 2016, deri në 20,9 % në vitin 2020.

Në vitin 2020, materialet fosile të energjisë kishin varësinë më të lartë nga importi, me rreth 47,4 %, të ndjekura nga mineralet dhe koncentratet metalike me 41,9 %. Nga ana tjetër varësinë më të ulët nga importet e kanë mineralet jo metalike me 11,0 %, të ndjekura nga inputet e biomasës me 16,3 %.

Tab. 5 Varësia nga importi i materialeve

(%)

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Biomasa	14,5	14,4	15,5	16,0	16,3
Mineralet dhe koncentratet metalike	38,9	38,0	33,3	30,8	41,9
Mineralet jo metalike	4,1	8,3	7,6	8,6	11,0
Materialet fosile të energjisë	43,4	38,4	36,6	43,1	47,4
Gjithsej	12,5	16,6	16,7	17,8	20,9


Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore mat sasinë totale vjetore të lëndëve të para që nxirren nga mjedisi, duke marrë në konsideratë dhe bilancin fizik tregtar. Në 2020, përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore arriti vlerën e rreth 19,3 milionë ton 14 % më pak, krahasuar me vitin 2019. Sipas strukturës së tij shohim që pjesën më të madhe të përdorimit të brendshëm të materialeve mjedisore e zënë produktet e “biomasës” me 43,7 % “mineralet jo metalike” me 41,8 %, “materialet fosile të energjisë” me 7,1 % dhe “mineralet dhe koncentratet metalike” me 7 % si dhe “produkte të tjera” me 0,4 %.

Tab.6 Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore

(mijë ton)

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Biomasa	9.104,8	9.173,5	9.062,4	8.802,5	8.429,0
Mineralet dhe koncentratet metalik	690,3	924,1	1.509,4	1.824,9	1.348,5
Mineralet jo metalike	17.566,5	10.089,2	10.505,5	10.260,5	8.065,3
Materialet fosile të energjisë	1.055,1	1.405,3	1.736,9	1.424,6	1.373,6
Produkte të tjera dhe mbetje	160,0	157,5	122,5	114,8	67,6
Gjithsej	28.576,7	21.749,6	22.936,8	22.427,3	19.284,0

Fig. 3 Struktura e përdorimit të brendshëm të materialeve mjedisore, 2020



Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore në raport me popullsinë u vlerësua në 6,8 ton / banor, duke shënuar një rënie prej 1,1 ton / banor, krahasuar me vitin 2019, kur kjo vlerë ishte rreth 7,9 ton / banor.

Tab.7 Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore në raport me popullsinë


(ton / banor)

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Biomasa	3,2	3,2	3,2	3,1	3,0
Mineralet dhe koncentratet metalike	0,2	0,3	0,5	0,6	0,5
Mineralet jo metalike	6,1	3,5	3,7	3,6	2,8
Materialet fosile të energjisë	0,4	0,5	0,6	0,5	0,5
Produkte të tjera dhe mbetje	0,1	0,1	0,0	0,0	0,0
Gjithsej	9,9	7,6	8,0	7,9	6,8

Figura e mëposhtme paraqet produktivitetin e burimeve në ekonominë Shqiptare për periudhën 2010 – 2020. Produktiviteti i burimeve llogaritet si raporti ndërmjet prodhimit të brendshëm bruto dhe përdorimit të brendshëm të materialeve mjedisore. Ky raport përfaqëson shumën e lekëve të gjeneruara për çdo kilogram material mjedisor që hyn në ekonominë e vendit. Në vitin 2020, produktiviteti i burimeve arriti vlerën prej 85 Lekë / kg, duke shënuar një rritje prej 9,8 Lekë / kg, krahasuar me vitin paraardhës.

Fig.4 Produktiviteti i burimeve 2010 - 2020

(Lekë / kg)



Metodologjia

Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore është një nga modulet e Llogarive Ekonomike në Mjedis. Qëllimi i tyre është integrimi i informacionit mjedisor në një mënyrë koherente me sistemin qendror të Llogarive Kombëtare.

Llogaritë e flukseve të materialeve mjedisore ka për objekt kryesor të përshkruaj lidhjen midis ekonomisë vendase dhe mjedisit natyror. Ajo përfshin sasinë totale të burimeve natyrore dhe produkteve të përdorura në ekonomi, në mënyrë direkte në prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve, ose indirekt përmes nxjerrjes së materialeve të cilat do të përdoren për prodhim.

Këto të dhëna janë subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/>

Disa nga kategoritë kryesore dhe indikatorët kryesorë të llogarive të flukseve të materialeve mjedisore janë:

Biomasa

Biomasa përfshin materialet organike jo fosile me origjinë biologjike. Sipas përkufizimeve të Llogarive të Flukseve të Materialeve Mjedisore, lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore përfshin të gjithë produktet bujqësore, peshqit dhe kafshët e gjuetisë. Blegtoria dhe produktet blegtorale (si p.sh qumështi, mishi, vezët) nuk përfshihen në këtë kategori.

Mineralet metalike dhe mineralet jo metalike

Mineralet metalike dhe mineralet jo metalike të përpunuara dhe të pa përpunuara janë dy grupe kryesore në kategoritë e materialeve mjedisore, sipas përkufizimeve të Llogarive të Flukseve Materiale Mjedisore, që përbëhen nga prodhimet e minierave, industria e ndërtimit dhe mineralet industriale.

Materialet Fosile të Energjisë

Përfshijnë burimet e naftës dhe materialet e tjera fosile të energjisë që janë formuara në të kaluarën gjeologjike, nga biomasa. Ato përfshijnë lëndet e ngurta, lëngjet dhe gazet.

Lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore

Lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore përfshin sasinë vjetore të lëndëve të para (me përjashtim të ujit dhe ajrit) të nxjerra nga mjedisi natyror për t'u përdorur në ekonomi, për qëllime ekonomike.

Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore

Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore mat shumën vjetore të lëndëve të para të nxjerra dhe të përdorura në ekonominë kombëtare, plus të gjitha importet fizike, minus të gjitha eksportet fizike.

Bilanci i Fizik Tregtar

Bilanci fizik tregtar është i barabartë me importet fizike minus eksportet fizike.

Varësia nga importi i materialeve (VI): llogaritet si raport i importeve mbi inputet direkte të materialeve (IDM), në përqindje. Termi 'varësia nga importet e materialeve' tregon shkallën në të cilën një ekonomi mbështetet në importe për të përmbushur nevojat e saj për materiale. Varësia nga importet e materialeve nuk mund të jetë negative ose më e lartë se 100%. Vlerat e barabarta me 100% tregojnë se nuk ka patur nxjerrje nga burimet e brendshme natyrore gjatë vitit të referimit.

$$VI = \frac{\text{Importe}}{(\text{Burimet e brendshme} + \text{Importe})}$$

Produktiviteti i burimeve përcakton një tregues që pasqyron PBB-në e gjeneruar për njësi të burimeve të përdorura nga ekonomia.

Burimi i të dhënave

Te dhënat e përdorura për Llogaritë e flukseve të Materialeve Mjedisore kanë burim të dhëna administrative të marra nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), Instituti i Statistikave (INSTAT) etj.

Metodologjia e përdorur për llogaritjen e tyre është bërë në përputhje me rregulloren (BE) Nr 691/2011 mbi Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore dhe manualeve të Eurostat.